

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Urbanistikën dhe Shërbimet

RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 03 datë 03.09.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit **Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Tropojë**

Komisioni i Shërbimeve të Këshillit Bashkiak Tropojë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi **Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Tropojë**, duke marrë në konsideratë rëndësinë e tij për zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Baza Ligjore

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe ndryshimet e tij;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 25.05.2016, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2016–2030”;
- Udhëzimet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve.

Rëndësia e Planit

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për Bashkinë Tropojë përbën një dokument strategjik, që synon:

- Të përmirësojë sistemin e grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve;
- Të reduktojë ndotjen mjedisore dhe të mbrojë shëndetin publik;
- Të nxisë riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve;

- Të harmonizojë praktikat vendore me objektivat kombëtare dhe direktivat e BE-së;
- Të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit dhe përfshirjen e tij në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

Përfundime dhe Rekomandime

Komisioni i Shërbimeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, konstaton se Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane është një instrument i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë Tropojë. Ky plan do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve publike, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve.

Në këtë kuadër, pas diskutimeve të hapura në degjese publike, Komisioni i Shërbimeve i propozon Këshillit Bashkiak Tropojë miratimin në tërësi të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane.